



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 12 (827816)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 24 mars 2023

Gjeneral brigade Arben Kingji zhvillon vizitë njohëse në Qendrën Stërvitore të Komandës Mbështetëse

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, Gjeneral brigade Arben Kingji zhvilloi një vizitë njohëse në Qendrën Stërvitore të Komandës Mbështetëse (KM) në Pezë - Helmës, nga ku ndoqi nga afër zhvillimin e kursit të Menaxhimit të Armatim - Municionit. SHSH-PFA gjeneral Kingji, i shoqëruar nga Drejtori i Shtabit të Përgjithshëm, kolonel Arben Zani dhe Komandanti i KM, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, takuan instruktorë dhe kursantë, të cilët aktualisht po zhvillojnë fazën e dytë

të këtij kursi, pjesë e së cilit janë dhe efektive nga radhët e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Disa nga qëllimet e kursit janë: Zhvillimi dhe konsolidimi i njohurive dhe aftësive mbi sigurinë fizike dhe menaxhimin e municioneve; Përgatitja e specialistëve sipas standardeve ndërkombëtare të Udhëzuesit Teknik Ndërkombëtar të Municioneve (IATG) dhe krijimi i mundësive për implementimin e tyre në rregulloren e armatim-municionit të Forcave të Armatosura. Komanda e Ushtrisë

Amerikane për Evropën vazhdon të japë një mbështetje të rëndësishme nëpërmjet programeve si: Programi Humanitar i Veprimt nga Minat (HMA) me fokus kryerjen e trajnimeve për personelin tonë në kurset EOD (niveli 1, 2, 3) me anë të metodës "Training the Trainer", dhe furnizimin e ekipeve të EOD me pajisjet e nevojshme. Si dhe, në ndërtimin e kapaciteteve të Sigurisë Fizike dhe Menaxhimin e Rezervave të Municioneve...

»» faqe 3



Peleshi në Forumin e Sigurisë dhe Mbrojtjes "Schuman": Bashkëpunimi, e vetmja rrugë për të siguruar paqen



Ambasadori i Republikës së Italisë në Shqipëri viziton KLSM-13

Ambasadori i Republikës së Italisë në Shqipëri, z. Fabrizio Bucci vizitoi Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM1-13), ku u prit nga drejtues të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, të cilët i uruan mirëseardhjen si përfaqësues i nivelit të lartë dhe e falënderuan për praninë e tij si "guest speaker" pranë grupit të KLSM-13. Nga ana e tij Ambasadori Bucci falënderoi të pranishmit dhe bashkëbisedoi me pjesëmarrësit për situatën aktuale të sigurisë dhe mbrojtjes në rajon dhe më gjerë si...



»» Faqe 2

Përkujtohet në Regjimentin e Operacioneve Speciale, 26-vjetori i rënies në krye të detyrës e Dëshmorit të Atdheut, kapiten I Nuredin Gorçe

Në ambientet e Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS), u zhvillua ceremonia përkujtimore e 26-vjetorit të rënies në krye të detyrës së Dëshmorit të Atdheut kapiten I Nuredin Gorçe. Në këtë aktivitet, ishin të pranishëm shefi i Shtabit të Forcës Tokësore, kolonel Beqir Tafili, zëvendëskomandanti i ROS n/kolonel Ajet Jata, familjarë dhe miq të Dëshmorit të Atdheut kapiten I Gorçe, efektive të ROS. Fjalën e rastit e mbajti komandanti i ROS n/kolonel Jata, i cili pasi bëri një rezymë të karrierës së...



»» Faqe 5

78-vjetori i themelimit të Shkollës Ushtarake 'Skënderbej' / Historia e një shkolle legjendë

Historia e një shkolle legjendë, në kolanën me 5 vume "Skënderbegasit ndër vite", e autorëve Kujtim Boriçi dhe Maksim Fejzullai. Më 28 mars 2023, mbushen plot 78 vjet kur çeli dyert në Tiranë shkolla e kadetëve, e cila më vonë mori emrin Shkolla e Mesme e Përgjithshme "Skënderbej", e vetmja shkolle e mesme me profil ushtarak në Shqipëri dhe shkolla e njohur elitare, me histori të madhe. Në dekada, historia e kësaj shkolle është dëshmuar me dokumente dhe do të pasurohet ndër breza, por një meritë e veçantë, unike në vend...



»» Faqe 10

Gjeneral brigade Arben Kingji zhvillon vizitë njohëse në Qendrën Stërvitore të Komandës Mbështetëse

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji zhvilloi një vizitë njohëse në Qendrën Stërvitore të Komandës Mbështetëse (KM) në Pezë - Helmës, nga ku ndoqi nga afër zhvillimin e kursit të Menaxhimit të Armatim - Municionit.

SHSHPFA gjeneral Kingji, i shoqëruar nga Drejtori i Shtabit të Përgjithshëm, kolonel Arben Zani dhe Komandanti i KM, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, takuan instruktorë dhe kursantë, të cilët aktualisht po zhvillojnë fazën e dytë të këtij kursi, pjesë e së cilit janë dhe efektivë nga radhët e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Disa nga qëllimet e kursit janë: Zhvillimi dhe konsolidimi i njohurive dhe aftësive mbi sigurinë fizike dhe menaxhimin e municioneve; Përgatitja e specialistëve sipas standardeve ndërkombëtare të Udhëzuesit Teknik Ndërkombëtar të Municioneve (IATG) dhe krijimi i mundësive për implementimin e tyre në rregulloren e armatim-municionit të Forcave të Armatosura.

Komanda e Ushtrisë Amerikane për Evropën vazhdon të japë një mbështetje të rëndësishme nëpërmjet programeve si: Programi Humanitar



i Veprimit nga Minat (HMA) me fokus kryerjen e trajnimeve për personelin tonë në kurset EOD (niveli 1, 2, 3) me anë të metodës "Training the Trainer", dhe furnizimin e ekipeve të EOD me pajisjet e nevojshme. Si dhe, në ndërtimin e kapaciteteve të Sigurisë Fizike dhe Menaxhimin

e Rezervave të Municioneve (PSSM Program), duke financuar projekte mbi përmirësimin infrastrukturor, trajnimet në fushën e municioneve, pajisjet për depot e municioneve, dhe përmirësimi i kapaciteteve testuese/vlerësuese të municioneve.



Ambasadori i Republikës së Italisë në Shqipëri viziton KLSM-13

Ambasadori i Republikës së Italisë në Shqipëri, z. Fabrizio Bucci vizitoi Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM1-13), ku u prit nga drejtues të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, të cilët i uruan mirëseardhjen si përfaqësues i nivelit të lartë dhe e falënderuan për praninë e tij si "guest speaker" pranë grupit të KLSM-13. Nga ana e tij Ambasadori Bucci falënderoi të pranishmit dhe bashkëbisedoi me pjesëmarrësit për situatën aktuale të sigurisë dhe mbrojtjes në rajon dhe më gjerë si dhe marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Italisë.



STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi mori pjesë në Forumin e Partneritetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes “Schuman”, me temë “Së bashku më të fortë, në një botë të paqëndrueshme”, që u mbajt në Bruksel.

Ministri Peleshi mori fjalën në panelin me temë “T’i përgjigjemi së bashku krizës”, ku foli për ndryshimin e sigurisë ndërkombëtare, pas agresionit rus në Ukrainë: “Imazhi i sigurisë ndërkombëtare ka ndryshuar thellësisht. Agresioni i pandërprerë rus ndaj Ukrainës ka nxjerrë në pah rëndësinë e sigurisë si një çështje politike. Pas tronditjes së skenës së sigurisë, konfliktet e mundshme të fjetura dhe çështjet e pazgjidhura ndërmjet shteteve janë bërë gjithnjë e më delikate. Vendet me të drejtë janë bërë më vigjilente dhe po ndërmarrin hapa për t’u përgatitur për konflikte të mundshme, duke rritur kapacitetet e tyre të mbrojtjes”, - u shpreh ministri Peleshi.

Sipas ministrit Peleshi, krizat e mëdha zakonisht e çojnë historinë në një nyje kritike dhe nevoja për zgjidhje oportune sjell në skenë idetë e mëdha inovative. Ai shtoi se ky forum mbahet pikërisht në një kohë kur paqja dhe siguria janë në kërcënim, ndaj shtoi ai: “Le ta kthejmë nevojën për zgjidhje në një shtysë për një kapërcim të qëndrueshëm në mënyrën sesi përgatitemi për të parandaluar krizat, në vend që të përballemi me pasojat e padëshiruara”.

Ministri i Mbrojtjes vuri theksin tek përpjekjet dhe investimet që po bëhen Shqipëria në bashkëpunim me SHBA-të, BE-në dhe NATO-n, sa i përket sigurisë kibernetike: “Forcimi i sigurisë kibernetike, kjo fushë e re luftarake, kërkon investime në infrastrukturë si edhe në kapacitetet njerëzore dhe duhet të zhvillohet në një kohë të shkurtër dhe njëkohësisht me një buxhet mjaft të madh”, - tha ministri.

Duke theksuar se vendet duhet të jenë më vigjilente ndaj kësaj lufte të re, me të cilën Shqipëria u përball vitin e kaluar, z. Peleshi tha se: “Përvoja e Shqipërisë mund të shërbejë si një ‘epruvetë’, ose shembull për vendet e tjera evropiane apo dhe vetë strukturat evropiane. Natyra e disa krizave shkon përtej kontrollit dhe aftësisë së një shteti të vetëm, pavarësisht nga fuqia apo pasuria e tij. Lufta kibernetike është një shembull klasik. Duke qenë se kjo lloj lufte nuk njih kufij, luftimi i saj brenda kufijve të një vendi është i pasuksesshëm”.

Ministri i Mbrojtjes foli edhe për rrezikun që i kanoset Ballkanit Perëndimor nga një përhapje e mundshme e konfliktit në Ukrainë: “Ballkani Perëndimor sot ndihet i kërcënuar si



Peleshi në Forumin e Sigurisë dhe Mbrojtjes “Schuman”: Bashkëpunimi, e vetmja rrugë për të siguruar paqen



nga ndryshimet gjeopolitike globale, por veçanërisht nga rreziku që mund të krijohet nga përhapja e mundshme

e luftës në Ukrainë. Ka vende që nuk kanë njohje reciproke, si Kosova dhe Serbia dhe ka vende ku dallimet

etnike mund të krijojnë destabilitetin, si Bosnja dhe Hercegovina. Për më tepër, prania e ndikimit rus në median

“Imazhi i sigurisë ndërkombëtare ka ndryshuar thellësisht. Agresioni i pandërprerë rus ndaj Ukrainës ka nxjerrë në pah rëndësinë e sigurisë si një çështje politike. Pas tronditjes së skenës së sigurisë, konfliktet e mundshme të fjetura dhe çështjet e pazgjidhura ndërmjet shteteve janë bërë gjithnjë e më delikate. Vendet me të drejtë janë bërë më vigjilente dhe po ndërmarrin hapa për t’u përgatitur për konflikte të mundshme, duke rritur kapacitetet e tyre të mbrojtjes”, - u shpreh ministri Peleshi.

dhe politikën e disa vendeve të rajonit ka shkaktuar shqetësim. Përballë këtyre rrethanave, e vetmja mënyrë për të siguruar paqen dhe stabilitetin është pjesëmarrja në ‘të njëjtin klub’, integrimi i përbashkët në strukturat euroatlantike. Në dallim nga njëri-tjetri kostoja e izolimit është edhe më e madhe se kostoja e integritimit. Dialogu Kosovë - Serbi dhe marrëveshja e pranuar reciprokisht së fundmi mund të lehtësojnë ‘pranverën’ e shumëpritur mes dy vendeve dhe të sjellin një epokë të artë të paqes dhe përparimit të garantuar për rajonin në familjen evropiane”, - u shpreh në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi.



Kolonel Arben Toska: Ndihe mi krenarë për produktin e punës suaj, ambicien drejt standardeve të avancuara, të denjë për të shërbyer në radhët e Forcave të Armatosura

Në mjediset e Qendrës së Arsimit Profesional të Ushtarëve, Vlorë, u zhvillua ceremonia e Certifikimit dhe Betimit të rekrutëve, të cilët përfunduan kursin e Stërvitjes Individuale Bazë (SIB). Në përfundim të këtij kursi në Bunavi, b1k, b3k të FT dhe batalionit të Mbështetjes së SHP, u certifikuan 63 rekrutë, të rinj e të reja, nga mbarë vendi, të cilët tashmë janë pjesë e Forcave tona të Armatosura.

Në ceremoni mori pjesë zëvendës-komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, kolonel Arben Toska, i cili shprehu vlerësime për rekrutët e sapo certifikuar dhe konsiderata të veçanta për ceremoninë e zhvilluar, gjithashtu falënderoi familjarët, të afërmit e rekrutëve pjesëmarrës në ceremoni, dhe personelin trajnues, ku ndër të tjera theksoi: “Ndihe mi krenarë për produktin e punës suaj, për këtë forcë ushtarake që keni stërvitur, për përpjekjet tuaja të vazhdueshme në drejtim të konsolidimit të sistemit të stërvitjes së ushtarit të Forcave të Armatosura, për ambicien tuaj për të zbatuar standarde të avancuara në procesin stërvitor, për gjithçka që ju keni bërë për edukimin e këtyre të



rinjve, tashmë të denjë për të shërbyer në radhët e Forcave të Armatosura”.

Gjatë fjalës së rastit në këtë ceremoni, komandanti i QAPU-ve, Nënkolonel Bujar Fejzo, ndër të tjera falënderoi rekrutët e sapo certifikuar, për përkushtimin dhe seriozitetin e treguar gjatë stërvitjes në Bunavi. Ai shprehu besimin se dijet dhe aftësitë e fituara do t’iu shërbejnë për të rritur më tej profesionalizmin gjatë kryerjes së detyrave në repartet e Forcave të Armatosura, ku do të shërbejnë. “Dita e sotme është e veçantë për Ju, - vijoi përshëndetjen nënkolonel Fejzo, - pasi do të betoheni si ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ju do të betoheni para flamurit tonë kombëtar, për t’i qëndruar besnik atdheut, detyrës dhe ligjit”.

Mes urimeve më të mira, rekrutët u përcollën nga Bunavia për në repartet e Forcave të Armatosura.

Kolonel Mëhillaj: Një kirurg shpëton jetën e një njeriu, ndërsa një specialist EOD shpëton shumë jetë njerëzish

Më 19 mars 1999, në Forcat e Armatosura mori jetë një grup i ri ekspertësh dhe profesionistësh xhener, i kompletuar me ekspertizën e duhur në lëmin e asgjësimit të municioneve të paplasura. Në këtë nënrepart u thirrën më të mirët e të mirëve, pasi ky profesion kërkon guxim, trimëri, zgjuars, qetësi dhe qartësi, për të marrë vendimin e duhur, ku jetën nga vdekja e ndan vetëm një vijë e hollë e padukshme. Për 24 vjet, kjo strukturë na ka bërë krenar si brenda dhe jashtë vendit duke ngritur për herë të parë flamurin tonë në Bosnjë, në Mali dhe tani në Letoni.

Falë punës së specialistëve EOD vendi ynë tani është më i pastër nga minat dhe eksplozivët e paplasur. Sot në këtë ditë të shënuar në ambientet e batalionit të xhenios u zhvillua ceremonia e 24-vjetorit të EOD. Në këtë ceremoni mori pjesë dhe Shefi i Shtabit të Komandës Mbështetëse, Kolonel Arben Dhuli si dhe të ftuar të tjerë. Fjalën e hapjes së ceremonisë e mbajti komandanti i batalionit të xhenios, kolonel Shkëlzen Mëhalla, i cili,



pasi falënderoi të pranishmit, theksoi se të jesh pjesë e EOD kërkon guxim, trimëri dhe vetëmohim, pasi në çdo

detyrë EOD ata sfidojnë vdekjen.

“Një kirurg shpëton jetën e një njeriu, ndërsa një specialist EOD

shpëton shumë jetë njerëzish”, - u shpreh koloneli. Gjithashtu kolonel Mëhillaj e vuri theksin në kompleti-

min e kësaj kompanie me pajisje nga më ato moderne të kohës, gjë që tregon kujdesin e Ministrisë Mbrojtjes për modernizimin e EOD. Më tej fjalën e mori komandanti i kompanisë EOD nënkolonel Artan Azizi. Në fjalën e tij ai, pasi theksoi rëndësinë e detyrës së EOD, u ndal në cilësitë që duhet të ketë një specialist EOD, duke theksuar se falë punës sot kompania EOD është një aset, jo vetëm për Komandën Mbështetëse, por për të gjithë Forcën e Armatosur. Por për të arritur deri këtu u desh dhe gjaku i 5 martirëve që dhanë jetën në krye të detyrës, e sot emri i tyre është gdhendur në historinë e ndritur të këtij reparti për t’u kujtuar përjetë. Ceremonia përfundoi me demonstrimet e pajisjeve që disponon sot kompania EOD.

Përkujtohet në Regjimentin e Operacioneve Speciale, 26-vjetori i rënies në krye të detyrës e Dëshmorit të Atdheut, kapiten I Nuredin Gorçe

Në ambientet e Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS), u zhvillua ceremonia përkujtimore e 26-vjetorit të rënies në krye të detyrës së Dëshmorit të Atdheut kapiten I Nuredin Gorçe.

Në këtë aktivitet, ishin të pranishëm shefi i Shtabit të Forcës Tokësore, kolonel Beqir Tafili, zëvendëskomandanti i ROS n/kolonel Ajet Jata, familjarë dhe miq të Dëshmorit të Atdheut kapiten I Gorçe, efektivë të ROS.

Fjalën e rastit e mbajti komandanti i ROS n/kolonel Jata, i cili pasi bëri një rezymë të karrierës së kapiten I Nuredin Gorçe, e vlerësoi veprën e tij si një akt burrëror dhe me vlera patriotike.

“Jeta dhe vepra e kapiten Gorçes, në shërbim të atdheut, duke kursyer as jetën e tij, përbën burim frymëzimi, jo vetëm për efektivët e ROS, por për të gjithë ushtarakët e Forcave të Armatosura”, - u shpreh ndër të tjera n/kolonel Jata.

Ceremonia vijoi më pas me vendosjen e kurorave dhe buqetave me lule, pranë bustit dhe memorialit kushtuar Dëshmorit të Atdheut kapiten Nuredin Gorçe.

Ish-shefi i xhenios së Brigadës “Komando”, u nda nga jeta në vitin e mbarshtë 1997.



“Dhuro gjak, shpëto jetë!”, Forca Tokësore qëndron gjithmonë në krah të njerëzve në nevojë

Me moton “Dhuro gjak, shpëto jetë!”, batalioni i Mbështetjes së Luftimit çeli fushatën e dhurimit të gjakut në Forcën Tokësore, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të transfuzionit të gjakut. Forca Tokësore qëndron gjithmonë në krah të njerëzve në nevojë.



Zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, priti në takim ekipin e radhës të Brigadës së Asistencës së Forcave të Sigurisë së SHBA-së (SFAB), me rastin e përfundimit të periudhës së shërbimit të tyre pranë Forcës Tokësore. Në vlerësim të punës së ushtarakëve amerikanë, për trajnimin e efektivëve të FT-së, gjeneral brigade Dimo, akordoi për personelin e SFAB Certifikatat e Mirënjohjes.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Unë pasardhësja e 'Evës' në epokën e silikonit

A ka qenie më të përsosur se sa qenia njerëzore?

Përse duhet deformuar NATYRA?! Hollivudi ishte emancipuesi dhe treguesi ideal i zgjuarsisë dhe aureolës së femrës në shoqërinë civile. Në çdo film shikon pjalmin e romancës njerëzore që përfton femra. Skenat dhe mizanskenat do ishin të shkreta, të egra, pa ngrohtësinë dhe kuriozitetin intrigues të botës së ëndrrave dhe realitetit magjik të femrës. Këtë e kuptuan mirë ujqërit e industrisë së Hollivudit, duke bërë një revolucion natyral në ndryshimin e sjelljes ndaj personalitetit magnetik të femrës. Por nuk mjaftoi veç kjo, por duhet të ndryshonim përmasat e tipareve tona aq shumë, sa që prindërit çuditërisht nuk po gjenin asgjë të përbashkët me pasardhësit e tyre. Tashmë është kthyer në 'trend' apo në një fenomen të frikshëm.

Dëshira për t'i 'ngjarë' kësaj apo asaj po na përball me të njohurit e panjohur në përballje.

Dëshiroj të shikoj femra me feminitetin e tyre, me sjellje të butë, me buzëqeshje plot hir, lëvizje joshëse, me fjalë të ëmbla dhe të sigurta në të njëjtën kohë. Me mendime origjinale dhe të reja.

Dëshiroj të shikoj femra të pavarura, jo skllave të burrave që sakrifikojnë dinjitetin e tyre.

Femra me zemra prej akulli të shkrirë, shoqe dhe mike të meshkujve, të lira dhe të singerta. Shpeshherë brengosemi me vendimet të cilat i marrim nëse do t'i pëlqejnë familjarëve apo shoqërisë. Dhe këtu fillojmë t'i ngjajmë atyre, të bëhemi si ata, dhe deformojmë fizikun dhe shpirtin, sepse ata nuk janë në raport të drejtë me njëri-tjetrin.

"Jeta është aq e mirë sa ju e lini të jetë"


Mos i bëni presion vetvetes, pasi që ju merrni nga jeta atë që ju e vini së pari aty. Dhe ndonjëherë, krejt çfarë duhet për një jetë të lumtur është një perspektivë e mirë.

Çdo femër ka bukurinë e saj, e cila varet nga truri, shpirti dhe ajo që trashëgon.

Fakti që çdo grua dëshiron të duket e shkëlqyer në sytë e grave të tjera është një fakt i padiskutueshëm. Dhe për këtë ato përdorin më së shumti teknika të ndryshme: duke filluar nga veshja dhe duke përfunduar me vetë imazhin. Efekti i dëshiruar mund të arrihet me aftësi të mira.

Përmes syve të tyre feminiteti përfaqëson integritetin dhe ndjenjën e masës.

Çdo grua që dëshiron të kënaqet të tjerët është femërore. Nënndërgjegjia intuitive i dikton rregullat e sjelljes, ajo bëhet e veçantë, ajo shkëlqen dhe



buzëqesh në një mënyrë tjetër.

Gruaja moderne është e sigurt në vetvete, e qetë dhe e lirë. Në përvojat dhe përshtypjet e përditshme, në historinë e jetës së saj është thurur femërore.

Një grua sot përball me frikën e saj, me veten, me dyshimet, shpresat dhe gëzimet e saj. Ekziston një perspektivë historike dhe kulturore për konceptin e një gruaje të vërtetë, dhe ka gjithashtu instalimet moderne dhe stereotipet. Janë ata që bëjnë presion mbi një grua, duke e detyruar atë të shqetësohet dhe të ndihet e paaftë.

Aktualisht, disa vajza nuk e ndiejnë unitetin e tyre me natyrën

Në të njëjtën kohë, të rejtat përpiqen të nxjerrin në pah sa më shumë seksualitetin e tyre, shpesh duken vulgare në të njëjtën kohë. Të gjitha këto opsione theksojnë mungesën e vetëdijes për feminitetin dhe pamundësinë për ta përdorur atë në mënyrë korrekte.

Vajzat që janë të vetëdijshme për natyrën e tyre rrallëherë janë rivale në sytë e palës tjetër.

Bukuroshet magjepsëse shpesh shkaktojnë acarim, dhe kjo fale 'investimit' fals që kanë bërë me 'asetet' e tyre.

Në mënyrë që një vajzë të fillojë të ndihet dhe të sillet sipas natyrës, ajo duhet të duket e rregullt dhe tërheqëse. Feminiteti dhe eleganca janë në lidhje të drejtpërdrejtë. Për të filluar të ndiejë natyrën e saj, një vajzë duhet të rishikojë rrënjësisht

veshjet e saj. Nuk ka nevojë t'u jepet përparësi modeleve ekstravagante dhe sfiduese. Është e nevojshme të zgjidhni ato stile dhe ngjyra që do të fshehin të metat ekzistuese dhe do të theksojnë dinjitetin e figurës. Mos i nënvlerësoni arritjet në kozmetologjinë moderne. Grimi kompetent ju lejon të theksoni shumë bukurinë natyrore dhe të jeni një grua më tërheqëse, pa pasur nevojë të helmosh veten me produkte që zgjasin pak dhe dëmtojnë përgjithmonë.

Edhe imazhi më ideal mund të priset nga ecja e gabuar, kështu që në këtë pikë duhet t'i kushtoni vëmendje të veçantë. Çdo hap duhet të jetë i këndshëm. Është e nevojshme të përpunohen aftësitë e mbledhjes, për shembull, nëse duhet të kapni një objekt të rënë, edhe kjo duhet bërë bukur.

Një vajzë që është e vetëdijshme për natyrën e saj, mund të vërehet menjëherë se ajo ka një lloj mençurie të kësaj bote dhe madje mund të heshtë me elokucencë kur është e nevojshme. Për të qenë femër, nuk është aspak e nevojshme të blini fustane të modës së fundit. Gjëja kryesore është ndjenja e shijes. Gjenerali tuaj dhe përpiquni ta përshtatni atë, mësoni të dalloni gjërat e bukura nga ato vulgare. "Gruaja duhet të duket si grua".

Në kërkim të përsosmërisë, shumë zonja i drejtohen ndihmës së kozmetologëve, rrisin qerpikët, modelojnë buzë dhe faqe. Megjithatë, jo të gjitha përmirësimet

e tilla pëlqehen.

Përfaqësuesit e seksit më të fortë besojnë se feminiteti i një gruaje nuk është tek format false. Për më tepër, në pjesën më të madhe, burrat nuk mendojnë fare nëse ajo është e bukur nga natyra apo falë përpjekjeve të saj. Por atyre nuk u pëlqen asgjë e panatyrshme.

E vërteta e pakushtëzuar është e gjitha feminiteti...

Rrjetet sociale, vrasës të heshtur?!

Gjithashtu nëpër rrjetet sociale imazhi i femrës vlerësohet në bazë të kilogramëve të produkteve të makijazhit që ajo përmban, botoksit që ka investuar dhe rrobave që ajo mban veshur. Një botë komplet sipërfaqësore, e dominuar nga kompleksi i dukjes së jashtme. Në këtë mënyrë, shumë vajza të reja, që ende janë në fazën e krijimit dhe zbulimit të vetes së tyre, krijojnë imazhin e femrës "ideale" që ato duhen të jenë.

Më besoni nuk ka të bëjë fare me idealen. E gjitha kjo lidhet me presionin shoqëror, i cili ka rol të vazhdueshëm nëpërmjet mekanizmave të tij, qofshin virtualë apo të botës reale, të cilët përcaktojnë parametrat e një femre. Ndonjëherë nuk duhet përjashtuar as vrapin e mundimshëm që bëhet për të ndjekur trendet globale, pa marrë parasysh se çka përfaqësojnë.

Por, gjersa janë globale, ato duhen ndjekur?!

Kjo është edhe logjika që ndihmon në bastardizimin në masë të shumë

elementeve që e përbëjnë shoqërinë. Duke kuptuar gjithë këtë ndikim, është fare e lehtë pastaj të shpjegosh atë që shohim çdo ditë, dhe ajo që shohim çdo ditë, nga grupmoshat e reja është vetëm refleksion i një mosbesimi të madh në vetvete që ky presion social shkakton.

Gjithmonë ka përjashtime edhe në këto stereotipe, sigurisht edhe në shoqërinë tonë, por ironia është që llumi i antivlerave dalëngadalë po arrin t'i zërë frymën vlerave. Fakti që hidhet vleri mbi personalitete publike femërore, është se zëri i tyre mund të dëgjohet, nëse ato refuzojnë të mos heshtin, sepse kemi parë shumë herë se po këto personalitete publike kanë qenë pre e këtij trajtimi që i bëhet sot femrës.

Nëse ne duam që të kemi femra të pavarura, që i kundërvihen këtij mentaliteti dhe jo ti nënshtrohen, nëse ne duam të kemi një barazi gjinore në raportet meshkuj-femra, cilin model duhet të ndjekë një adoleshente, por njëkohësisht cili është edhe opinionin që një adoleshent mashkull duhet të ketë mbi gjininë e kundërt?! ... Të vazhës së Instagramit, asaj me rroba 'firmato', asaj që e mendon veten pjesë të një bote surreale?!

Pozita e femrës në një shoqëri të caktuar është indikator dhe përshkruesi më i mirë, i mendësisë së gjinisë së kundërt. Kjo nuk i prek vetëm femrat, si pjesë përbërëse të shoqërisë, por prek shoqërinë në tërësi, dhe si fenomen i cili futet aq thellë në shoqëri nuk duhet të jetë sferë interesi vetëm për një bllok të caktuar.

Skënderbegasi Fatos Myftari, inxhinieri i talentuar shqiptar, menaxher në "Apple", Kaliforni

Fatos Myftari është një prej ish-skënderbegasve me karrierë të shkëlqyer në fushën inxhinierike, duke kontribuar në projekte të rëndësishme të kompanive më të mëdha elektronike në botë.

Ai u lind në qytezën e Ulzës në rrethin e Matit, më 15 gusht të vitit 1969, në një familje të madhe me shumë fëmijë, punëtore, të ndershme e me gjendje ekonomike të varfër. Që në vogëli ai u ushqye me dashurinë për njerëzit dhe për shkollën. Ai u shqua gjatë ndjekjes së shkollës 8-vjeçare në këtë qytezë, në shkencat ekzakte si matematikë, fizikë e kimi. Siç kujton edhe vetë Fatosi, mësuesit e kësaj shkolle ishin të ardhur nga Tirana, Durrësi, etj. Kujtojmë që kjo qytezë u krijua gjatë viteve të ndërtimit të HEC-it të Ulzës. Edhe babai i Fatosit me familjen e tij, pikërisht në ato vite vendoset në qytezën e Ulzës. Ai mbaron shkollën 8-vjeçare në vitin 1983, me rezultate të shkëlqyera, me mesataren 10. Por në atë kohë qyteza e Ulzës nuk kishte shkollë të mesme, kështu që atij i duhej të shkonte në një qytet ku të kishte shkollë të mesme. Këshilli Popullor aty, duke qenë se nxënësi Fatos Myftari ishte bir i një familjeje të shkëlqyer, vendos që ai të shkojë për studime në shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej". Babai i tij, një skraparlli patriot, gëzohet pa masë pasi edhe ai vetë kishte punuar në ushtri për disa vite.

Kështu Fatosi, në shtator të vitit 1983, fillon studimet në Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej", studime që i përfundoi në vitin 1987, po me rezultate të shkëlqyera, me mesatare 10. Ishin tre nxënës të tillë në atë maturë, Fatosi, Fatri Nesimi dhe Fatos Olldashi. Këtyrë të fundit i akordohet bursë studimi për Mjekësi, kurse Fatosit e Patriut iu akordohet bursë studimi për Inxhinieri Elektronike. Fatos Myftari mbaroi studimet në këtë degë me rezultate të shkëlqyera. Ai radhitet ndër më të mirët e atij brezi. Ai pati fatin të jetë pjesëmarrës aktiv në lëvizjen studentore të Dhjetorit 1990, për ndryshimin e sistemit. Pasi mbaroi studimet në vitin 1992, ai punon për dy vite në KESH, në degën Ulzë, si inxhinier elektronik. Në vitin 1994 atij i ofrohet një mundësi trajnimi për një muaj nga "Alcatel Italia" në Romë. Dhe kështu në fund të nëntorit të atij viti, ai nis për në Romë me një mendim të qartë se kjo do të jetë një rrugë pa kthim. Pasi mbaron trajnimin, pas shumë peripeçish nëpër kufij shtetërorë, ai mbërrin në Dortmund të Gjermanisë, ku bashkohet me vëllain e tij. Fatosit, Gjermania e asaj kohe i dukej jo premtuese për emigrantët shqiptarë, prandaj ai lidhet me një shokun e tij të fakultetit që jetonte në Londër dhe me shumë vështirësi mbërrin në Londër, në fillim të marsit 1995. Fatosi kishte një ëndërr në mendjen e



tij për të jetuar e punuar në SHBA ose Kanada. Gjatë qëndrimit në Londër ai punon si kamerier në një restorant italian dhe njëkohësisht ndiqte kurs intensiv për gjuhën angleze. Në gusht të vitit 1995, i jepet mundësia për të emigruar në Kanada. Por jeta aty ishte mjaft e vështirë sa për shkak të motit shumë të ftohtë, aq edhe për shkak të mungesës së njohjeve për mundësitë e punësimit.

Gjithnjë Fatosi mbante të gjallë dëshirën për të vijuar studimet dhe trajnimet e mëtejshme për të punuar në profesionin e nderuar të inxhinierit. Kështu ai regjistrohet në "Denvry University Toronto", në vitin 1997 dhe në dhjetor të vitit 2000 mbaron studimet me rezultatin maksimal 4.0/4.0. Dy muaj më pas, në shkurt 2001, fillon punë si inxhinier elektronik në kompaninë e mirënjohur zviceriano-kanadeze "Uniton Hearing", në Ontario. Në këtë kompani menjëherë shquhet për profesionalizëm të lartë dhe kreativitet, duke bërë karrierë të shpejtë deri në Senior Engineer. Gjatë kësaj kohe ai merr pjesë në një projekt të rëndësishëm, për 6 muaj, në zyrat

kryesore të kompanisë në Stafa, pranë Zyrhut. Këtu u prodhua pajisja e parë e dëgjimit wireless. Ndërkohë që punonte me kohë të plotë, ai ndjek edhe studimet në "Ryerson University", Toronto, për Master Shkencor, specializim në algoritëm për Audio Technologies, që e përfundon më 2005. Pikërisht në këtë kohë kompania kanadeze "Research in Motion", kërkonte inxhinierë të talentuar për t'i punësuar në "Blackberry". Fatosi përzgjidhet nga kjo kompani dhe fillon punë më 2006 në "Blackberry", ku ai me aftësitë e shkëlqyera profesionale, dha një kontribut të vyer në shumë projekte. Ndërkohë ai merr edhe pasaportën kanadeze dhe tashmë udhëton si qytetar kanadez në shumë vende të botës për nevoja të zhvillimit të projekteve.

Pikërisht në këtë kohë, kur emri dhe fama e tij qenë lançar në nivelet më të larta, "Apple" i ofron Fatosit një vend pune me një pozicion të preferuar, të cilin ai nuk mund ta refuzonte. Kështu që në prill të vitit 2011, ai nis punë si inxhinier i "Apple" në Cupertino

në Kaliforni, ku vijon të punojë edhe sot dhe mban pozicionin "Manager of Audio Systems". Në këtë pozicion ai menaxhon një ekip prej 8 inxhinierësh. Gjatë kësaj periudhe ai realizoi edhe një master për Administrim Bisnesi.

Fatosi në memorien e tij mban të freskët shkollën, që i forcoi dëshirën për studim, korrektesë dhe disiplinë, çka e ndihmoi të përshtatej lehtësisht me kriteret e botës perëndimore.

Vetë Fatosi në kujtimet e tij do shkruante mbi emocionet dhe dashurinë e jetës Skënderbegase:

Nga jeta në shkollën ushtarake "Skënderbej", konservoj në kujtesën time shumë momente të bukura, aq sa është e vështirë të veçosh diçka. Shumë jetë intensive, shumë ngjarje e shumë emocione të përjetuara. Gjithsesi, disa momente të veçanta vështirë të harrohen, të nguliten thellë në memorie dhe herë pas here të grishin të rijetosh e të krenohesh, pse jo.

Së pari, dua të kujtoj momentin që më lidh më së shumti me studimet e mia në shkollën "Skënderbej", të paktën kështu e mendoj unë. Babai im, Ferit Myftari, ka lindur në Vërzehzhë të Skraparit. Mbaroi arsimin 8-vjeçar aty dhe, pasi martohet me mamanë time, Sheqeren, më 1950, nisin jetën familjare të vështirë për kohën. Pas një kursi të kohës, ai emërohet si polic në Burrel të Matit. Ishte koha kur Shqipëria e dalë nga lufta kishte nisur shërimin e plagëve dhe ndërtimin e jetës së re. Në këtë kuadër kërkoheshin fuqi punëtore për ndërtimin e HEC. Kështu, babai transferohet në Ulzë si polic, ku punoi deri më 1970. Vitet e tij të punës si ushtarak mendoj se kanë ndikuar më shumë në akordimin e bursës për shkollë ushtarake, prej autoriteteve të vendit. Kjo justifikon edhe gëzimin e papërshkrueshëm të tij kur na u komunikua vendimi. E kujtoj këtë moment shpesh, pasi ai ka ndërruar jetë më 1988.

Moment që nuk e harroj është momenti i mbërritjes në shkollën "Skënderbej". Një fëmijë 14-vjeçar, që sapo vinte këmbën në adoleshencë, ardhur prej diku larg, me një valixhe druri me ca plaçka e me ca kulaçe gruri të bëra mrekullisht nga dora e nënës sime të mirë, që edhe sot më mungojnë pas vdekjes së saj më 2016, gjen aty një ngrohtësi të paparë nga i gjithë stafi pedagogjik e ushtarak. E thashë një fëmijë enkas, sepse në fund të shkollës, ne qemë burrëruar

papritur, qemë rritur jo vetë në shtat, falë rregullit, disiplinës dhe kalitjes së gjithanshme. Dhe ne e ndjenim këtë dita ditës.

Nuk mund të le pa përmendur nivelin e lartë profesional të mësuesve tanë, dashurinë dhe përkushtimin e tyre në injektimin e dijes tek ne. Ja, si sot e ndjej dorën dhe zërin e tyre të ngrohtë, përkujdesjen e tyre prindërore nga, Asimaq Proko, Ana Prifti, Saimira Dedej, mësuesja kujdestare Hamide Daja, Lireta Ziu, etj. Do të veçoja prof. Asimaqin. Ai shihte veten e tij tek ne, sepse ai kish qenë vetë skënderbegas. Ai ishte metodist i shkëlqyer në mësimdhënie, motivues dhe ndihmues për më të dobëtit. Përmes grupeve të patronazhit që ishin mjaft funksionale dhe Asimaqi ishte gjithnjë aty. Kjo forconte edhe shoqërinë e miqësinë me njëri-tjetrin. Unë kam studiuar në disa universitete, kam lidhur shumë shoqëri e miqësi, por si ato të shkollës "Skënderbej" kurrë. Në fund të katër viteve ne ishim vëllezër për njëri-tjetrin.

Kam dhe një kujtim interesant, që ka të bëjë me përgatitjen fizike. Zakonisht nxënësit e mirë janë të dobët në fizikulturë. Dhe unë isha një shembull konkret. Unë kam qenë një brez me Dritan Demiraj. Mësuesi i fizikulturës, Flamur Sharra e caktoi Dritanin të më ndihmonte pas mësimit në palestrenë e shkollës. Me ndihmën e Dritanit, jo vetëm që mora 10, por u bëra mjeshtër në paralele. Kalitja me vështirësitë dhe këmbëngulja për t'u shkuar deri në fund gjërave, është një prej mbresave të pashlyeshme. Ne e bënim stërvitjen dimërore në Voskopojë të Korçës. Deri në fshatin Voskop, shkonim me mjete transporti. Prej aty deri në Voskopojë, bëhej me marshim. Një marshim i vështirë në kohë dimri me dëborë e me ngarkesë të konsiderueshme armatimi. Ne nuk dorëzoheshim. Ndihmonim njëri-tjetrin sa mundnim. Në fund, ishim krenarë se ia kishim dalë, se nuk ishim dorëzuar për asnjë çast. Eh... ky ishte burrërimi ynë para kohe.

Sigurisht, momenti më emocionues është kur m'u komunikua që do të shkoja në Universitet, do të studioja për Inxhinieri Elektronike. Ishte ëndërra ime, të cilën e kisha ushqyer për vite me radhë. Kam qarë dy ditë me radhë. Nuk arrija ta besoja, aq sa për shumë ditë e mbajta lajmin si një sekret timin...



ZENO JAHAJ

Nga frika e 'Perëndimit' në shtratin e 'Azisë'

Një miqësi e dendur, e shpallur nga të dy si "pa kufizime". Dy fuqi autoritare, njëra në Europë dhe tjetra në Azi, të uritura për të përmbysur rendin global. Për llogari të përbashkët, por edhe për llogari të ndara. Ku e ku, edhe histori të përbashkët, por edhe të hidhur. Kështu që, njëra prej tyre mund ta humbasë arsyen.

Në Europë, prej një viti zhvillohet luftë, në dukje e Putinit kundër Ukrainës, në thelb, e Putinit me Perëndimin dhe e Perëndimit me Putinin. Putini luan me frikën se Perëndimi po i afrohet si shumë. Perëndimi, përkatësisht SHBA-ja, luan për të ndalur oreksin e mëtejshëm ekspansionist që do të hapte pushtimi rus i Ukrainës dhe kështu, përmbysjen e ekuilibrave në Europë. Prandaj, SHBA-ja iu gjend Ukrainës njësoj siç iu gjend Mbretërisë së Bashkuar, Bashkimit Sovjetik, Francës dhe shteteve të tjera aleate, që në vitin 1941 të Luftës së Dytë Botërore.

Në Azinë Lindore, nuk ka ende luftë, por gjithsesi ka një retorikë të egër lufte. Dhe një buxhet lufte, ku ai i shpalluri i Kinës për vitin 2023 është 224.8 miliardë dollarë. I shpalluri, dyfishi. Tajvani dhe Deti i Kinës Jugore janë arsye, si për kinezët, edhe për amerikanët. Marrëveshja e para pak ditëve midis Presidentit Biden, Kryeministrit britanik Sunak dhe Kryeministrit australian, Albanese, për furnizimin e Australisë me nëndetëse të armatosura konvencionale, por që funksionojnë me energji bërthamore, është një arsye tjetër. Por ka një arsye më të madhe: rajoni i Oqeanit Indian dhe Paqësor me më shumë se gjysmën e popullsisë së botës, është vatra e dy të tretave të ekonomisë botërore.

Kështu, bota ndodhet në prag të një konflikti fuqish të mëdha. Një situatë e ngjashme si ajo e dhjetorit të vitit 1941, ku Gjermania dhe Japonia vendosnin nëse do të përballeshin ose jo me hegjemonët globalë, përpara se të ishte tepër vonë. Që nga Lufta e Dytë Botërore, gjeopolitika e botës është modeluar nga trekëndëshi strategjik Kinë-Rusi-SHBA. Në atë kohë, bashkësia e interesave, jo vetëm ideologjike Kinë-BRSS, nxitu reagimin amerikan për të ndaluar përhapjen e komunizmit, çka e çoi SHBA-në në luftë në Kore, Vietnam e gjetkë. Por në vitin 1972, Sekretari i Departamentit të Shtetit Kissinger do t'i propozonte Presidentit të vet Nikson të mirëkuptonte interesat gjeopolitike të Kinës dhe SHBA të bëhej aleat me të për të rrethuar, frenuar e shkundur BRSS-në, çka e transformoi bazën e mëparshme të trekëndëshit nga një aleancë BRSS-Kinë në aleancën SHBA-Kinë. (Ishte pikërisht ajo kohë kur Shqipërisë i erdhi një propozim zyrtar nga Zëvendësi i Kissinger, për ta futur



BOTA NDODHET NË PRAG TË NJË KONFLIKTI FUQISH TË MËDHA. NJË SITUATË E NGJASHME SI AJO E DHJETORIT TË VITIT 1941, KU GJERMANIA DHE JAPONIA VENDOSNIN NËSE DO TË PËRBALLESHIN OSE JO ME HEGJEMONËT GLOBALË, PËRPARA SE TË ISHTE TEPËR VONË. QË NGA LUFTA E DYTË BOTËRORE, GJEOPOLITIKA E BOTËS ËSHTË MODELUAR NGA TREKËNDËSHI STRATEGJIK KINË-RUSI-SHBA.

edhe Shqipërinë në këtë valle gjeopolitike, të cilin, Enver Hoxha, për arsye të leximeve të veta gjeopolitike, e refuzoi.) Sot, baza e trekëndëshit është rikthyer te Rusia dhe Kina, por në raporte të përmbysura në krahasim me ato të Stalinit e Mao Ce Dunit. Në atë kohë ishte Bashkimi Sovjetik, përkatësisht Rusia që diktonte rregullat e lojës, ndërsa sot është e kundërta. Sidoqoftë, Putini e mori i pari iniciativën operacionale: shpalli dhe vazhdon luftën, edhe pse i izoluar totalisht nga bota dhe madje, tashmë edhe i akuzuar për gjenocid ajror dhe krime të tjera lufte. Një vendim i pakthyeshëm i Gjykatës Ndërkombëtare Penale në Hagë, që do të thotë, të paktën, Putini kurrë nuk do të jetë pjesë e tavolinave ndërkombëtare, edhe sikur të rizgjidhet president, çka nuk është pak në botën e sotme të forcës së diplomacisë. Se diplomacia e forcës dihet se ku do ta çojë.

Nga ana tjetër, Xi po përdor aleancën e tij ruse për të dobësuar dhe penguar SHBA-në. Dhe do të paraqesë një paketë për plan paqeje. Putini mund të mos jetë plotësisht dakord me lojën që do t'i propozojë Xi, por nuk është aq i fortë sa të mos e pranojë. Nuk përjashtohet që edhe të humbasë arsyen, se nuk ka çfarë të humbasë më. Aktakuza e Gjykatës Ndërkombëtare Penale në Hagë është një mesazh për të, se një ditë do të japë llogaritë siç dha, për shembull, Millosheviçi.

Sidoqoftë, Rusia, si fuqia e njëmbëdhjetë në botë për nga prodhimi i përgjithshëm, dhe jo pak e konsumuar materialisht e moralisht nga lufta në Ukrainë, ka nevojë për të mbetur në skenë gjeopolitikisht dhe për të kërkuar ndihma materiale. Më mirë se Kinës nuk kishte kujt t'i drejtohej. I bashkon gjeografia, autoritarizmi, nevoja e ndërsjellë për

shkëmbime tregtare, etj. Kina ka nevojë për hapësira demografike në Siberi dhe për gazin rus. Rusia ka nevojë për armë dhe mbështetje ekonomike, financiare e diplomatike. Gjithsesi është një marrëdhënie disfunkcionale, ku partneri dominant është Kina, për faktin se ka fuqinë shumë më të madhe ekonomike, e dyta në botë.

Koha dhe gjeografia janë dy aktorë dominantë që do të përcaktojnë shumë se çfarë do të zhvillohet. Në këtë kënd, ekuilibri ushtarak rajonal në Paqësor, është në favor të Kinës. Në rast të një sulmi amfib të Kinës ndaj Tajvanit, prania ushtarake atje e SHBA-së mund të gjendet shumë shpejt e konsumuar ndërsa rezervat strategjike mund të gjenden shumë të vonuara për shkak të largësisë gjeografike dhe, rrjedhimisht, kohës së gjatë të afrimit. Ndërkohë, Kina ka avantazh pikërisht numrat, gjeografinë dhe kohën. Në vatrën tjetër, Ukraina është po kaq larg në kohë dhe

gjeografi. Për më tepër, nëse hapen të dy frontet njëherësh, pasiguria është e sigurt. Do të jenë interesat strategjike që do të vendosin. Xi Jinping nuk ka interes që Putini të mposhtet, sepse paqëndrueshmëria, rënia apo, akoma më keq, shkoqja e Rosisë, e fut Kinën në rrethim të plotë strategjik. Një luftë e vazhdueshme e Rosisë që shpërqendron dhe varfëron SHBA-në, sfiduesin kryesor të Kinës, dhe që ndan Evropën dhe NATO-n, i përshtatet bukur fort interesave të Kinës. Prandaj Xi vlerësohet se do ta portretizojë veten si një ndërmjetës me peshë, që e mban Rusinë në këmbë, sigurisht jo aq të fort sa të mos ia ketë nevojën Kinës. Kështu, Xi avancoi edhe ambicien e tij për të udhëhequr një rend botëror alternativ, jodemokratik, joliberal, për të zëvendësuar status quo-në e dominuar nga SHBA-ja. Prandaj nuk duket se do shkohet në konflikt të mëtejshëm ushtarak. Hë për hë, Kina nuk e ka këtë interes. Do t'i mëshojë më shumë formatit gjeopolitik të fuqisë në krahasim me atë ushtarak. Në këtë kuadër, do të kemi një përprjekje të vendeve Grupit BRICS (Brazil, Rusi, Indi, Kinë dhe Afrikës së Jugut) për zhvillimin e një monedhe të re rezervë globale duke de-dollarizuar botën dhe kështu, pakësimin e peshës gjeopolitike të SHBA-së. A do të formësojë SHBA në këto rrethana, një "NATO" tjetër, ndoshta një NPTO (North Pacific Treaty Organization)? Hijet janë hedhur. Çka do të thotë se evropianët do të duhet të mbështeten shumë më shumë te vetvetja se deri më sot. Çka ishte një arsye e fortë pse Gjermania po shndërron në fuqinë e tretë në botë për nga buxheti i mbrojtjes. Edhe të tjerët, kanë shumë arsye.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I NATO-S, JENS STOLTENBERG PUBLIKON RAPORTIN E TIJ VJETOR 2022

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

2022, vit kyç për sigurinë e Aleancës

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, zbuloi për publikun raportin e tij vjetor për vitin 2022, duke trajtuar të gjitha aspektet e punës së Aleancës gjatë vitit të kaluar.

Ndërsa lufta e Rusisë kundër Ukrainës hyn në vitin e saj të dytë, Stoltenberg vlerësoi rezistencën e fortë të popullit ukrainas dhe mbështetjen e paprecedentë ndaj Ukrainës nga aleatët e NATO-s. Ai tha se Presidenti Putin dëshironte më pak NATO, por ka marrë pikërisht të kundërtën, më shumë NATO dhe nënvizoi se "pranimi i Finlandës dhe Suedisë do t'i bëjë ata më të sigurt, Aleancën tonë më të fortë dhe do të tregojë se dera e NATO-s mbetet e hapur".

"Pushtimi i Putinit ishte një tronditje, por nuk ishte një surprizë", - tha Stoltenberg, duke e quajtur atë, kulmi i një modeli veprimi agresiv. Ai shtoi se që nga aneksimi i paligjshëm i Krimesë nga Rusia në vitin 2014, NATO ka zbatuar përfundimisht më të madh të mbrojtjes kolektive në një brez. "Kur tanket ruse u futën në Ukrainë, ne ishim gati, - tha ai. Brenda orëve, ne aktivizuam planet tona të mbrojtjes nga Baltiku në Detin e Zi. Ne vendosëm 40 000 trupa nën komandën e NATO-s, me një prani të konsiderueshme ajrore dhe detare, dhe dyfishuam numrin e grupeve luftarake të NATO-s nga katër, në tetë". Stoltenberg shtoi se aleatët e NATO-s i kanë ofruar Ukrainës mbështetje të konsiderueshme, përfshirë sisteme të avancuara të armëve dhe municione. Për të ruajtur mbështetjen për Ukrainën, duke mbrojtur Aleancën, aleatët janë gjithashtu në procesin e marrëveshjes për objektivat e reja të aftësisë për prodhimin e municioneve vendimtare për betejën dhe duke u angazhuar me industrinë për të rritur prodhimin. NATO po rrit gjithashtu mbrojtjen e infrastrukturës kritike kombëtare, përfshirë kabllot dhe tubacionet nënujore, veçanërisht nëpërmjet krijimit të Njësisë Koordinuese të Infrastrukturës Nënujore dhe Task Forcës të përbashkët NATO-BE.

Stoltenberg theksoi se në Samitin e Madridit 2022, aleatët miratuan Konceptin e ri Strategjik, i cili identifikon Rusinë si kërcënimin më të rëndësishëm për sigurinë, krahas terrorizmit, dhe bën të qarta sfidat që Kina i paraqet Aleancës. Ai përsëriti që viti 2022 ishte viti i tetë radhazi i rritjes së shpenzimeve të mbrojtjes në të gjithë Evropën dhe në Kanada, duke arritur në një rritje prej 2.2% në terma realë dhe një total prej 350 miliardë dollarë shtesë që nga viti 2014. "Ne po ecim në drejtimin e duhur, por ne nuk po lëvizim aq shpejt sa kërkon bota e rrezikshme në të cilën jetojmë, - tha ai, duke shtuar se, - ... është e qartë se duhet të bëjmë më shumë dhe duhet ta bëjmë më shpejt". Stoltenberg tha se ai pret që aleatët të bien dakord për një premtim të ri ambicioz për investimet e mbrojtjes në Samitin e Vilniusit në korrik, me 2% të PBB-së si minimum për t'u investuar në mbrojtje.

Aleanca demonstron se dera e NATO-s mbetet e hapur

"Sot po prezantoj Raportin tim Vjetor për vitin 2022. Ky raport përmbledh aktivitetet kryesore të Aleancës sonë në vitin e fundit. 2022 ishte një vit kyç për sigurinë tonë. Lufta ilegale e Rusisë kundër Ukrainës po hyn tani në vitin e dytë. Presidenti Putin bëri një gabim të madh strategjik kur pushtoi Ukrainën. Ai priste që Kievit do të binte brenda disa ditësh dhe e gjithë Ukraina brenda javësh. Por ai nënvlerësoi rezistencën e çeliktë të popullit ukrainas. Ai mendonte se mund ta prishte unitetin e NATO-s. Por aleatët e NATO-s po qëndrojnë të fortë dhe të bashkuar dhe po ofrojnë mbështetje të paprecedentë për Ukrainën. Ai donte më pak NATO. Por ai ka pikërisht të kundërtën. Më shumë NATO", - tha Jens Stoltenberg, më 21



mars 2023, teksa raportoi për vitin 2022 në një konferencë për mediat.

Nga ana tjetër në përgjigje të luftës së paligjshme të Rusisë, Finlanda dhe Suedia vendosën të aplikojnë për anëtarësim në NATO, që do të dyfishojë gjatësinë e kufirit të NATO-s me Rusinë, tha ai. Gjithashtu në Samitin e NATO-s në Madrid qershorin e kaluar, të gjithë aleatët morën vendimin historik për të ftuar Finlandën dhe Suedinë për t'u bashkuar. Të dy vendet kanë adresuar shqetësimet legjitime të sigurisë së Turqisë dhe përbushen angazhimet e tyre sipas Memorandumit Trepalësh, të rënë dakord në Madrid. Turqia tani është gati të ratifikojë anëtarësimin e Finlandës në NATO. "E mirëpres atë vendim dhe mezi pres që Asambleja e Madhe Kombëtare të ratifikojë pranimin e Finlandës përpara zgjedhjeve të ardhshme të përgjithshme turke. Unë mirëpres gjithashtu që parlamenti hungarez do të votojë për Finlandën javën e ardhshme", - tha Stoltenberg. "Gjëja më e rëndësishme është që Finlanda dhe Suedia të bëhen shpejt anëtarë të plotë të NATO-s dhe nëse ato nuk bashkohen saktësisht në të njëjtën kohë, unë do të vazhdoj të punoj shumë për të siguruar që Suedia të bëhet anëtarë e plotë sa më shpejt të jetë e mundur. Pranimi i Finlandës dhe Suedisë do t'i bëjë këto shtete më të sigurta, Aleanca më e fortë dhe demonstron se dera e NATO-s mbetet e hapur."

Finlanda dhe Suedia aktualisht kanë një pozicion krejtësisht të ri në NATO, pasi me pozicionin si të ftuar që ato kanë, do të thotë se ato ulen në tryezën e NATO-s dhe Aleanca po integrohet me Finlandën dhe Suedinë gjithnjë e më shumë në strukturat civile dhe ushtarake të NATO-s. "Pra, integrimi ushtarak vazhdon, pavarësisht që Hungaria dhe Turqia nuk e kanë ratifikuar ende, sepse pjesë e të qenit i ftuar do të thotë që mund të integrohesh në strukturat ushtarake të NATO-s, përfshirë objektivat e aftësive të përkohshme. Pra, procesi i integritit të planifikimit ushtarak është diçka që po ecën përpara dhe nuk vonohet nga procesi i ratifikimit".

Mjedisi i sigurisë ka ndryshuar për një afat të gjatë

"Presidenti Putin dëshiron një Evropë ndryshe. Ai i sheh demokracinë dhe lirinë si një kërcënim dhe ai kërkon të kontrollojë fqinjët e tij. Pra, edhe nëse lufta në Ukrainë përfundon nesër, mjedisi i sigurisë ka ndryshuar për një afat të gjatë. Pushtimi i Putinit vitin e kaluar ishte një tronditje, por nuk ishte një surprizë. Ishte kulmi i një modeli veprimi agresiv. Por si përgjigje, që

ranë dakord për Betimin e Investimeve të Mbrojtjes në vitin 2014, aleatët evropianë dhe Kanadaja kanë shpenzuar 350 miliardë dollarë shtesë për mbrojtjen. Shumë aleatë kanë njoftuar gjithashtu rritje të konsiderueshme të shpenzimeve të mbrojtjes që nga pushtimi i Rusisë.

"Tani këto zotime duhet të kthehen në para të vërteta, kontrata dhe pajisje konkrete, sepse shpenzimet e mbrojtjes mbështesin gjithçka që bëjmë. Që nga viti 2014, aleatët kanë rritur shpenzimet e mbrojtjes dhe ne po ecim në drejtimin e duhur. Por ne nuk po ecim aq shpejt sa kërkon bota e rrezikshme në të cilën jetojmë. Pra, ndërsa unë mirëpres të gjithë përparimin që është bërë, është e qartë se ne duhet të bëjmë më shumë dhe ne duhet ta bëjmë atë më shpejt. Në Samitin e NATO-s në Vilnius në korrik, pritet që aleatët të bien dakord për një premtim të ri më ambicioz për investimet e mbrojtjes, me një minimum prej 2% të PBB-së për t'u investuar në mbrojtjen tonë. Në këtë botë të re dhe më të kontestuar, NATO nuk mund ta marrë sigurinë e saj si të mirëqenë. Është siguria jonë ajo që mbështet prosperitetin dhe mënyrën tonë të jetesës", - tha Stoltenberg. Ai tha se sondazhi i fundit tregon se "82% e njerëzve në të 30 aleatët e NATO-s besojnë se është e rëndësishme që Amerika e Veriut dhe Evropa të punojnë së bashku për sigurinë e përbashkët, dhe se 61% pajtohen se anëtarësimi në NATO e bën më pak të mundshëm një sulm nga një komb i huaj. NATO i ka mundësuar Evropës dhe Amerikës së Veriut të jetojnë në paqe për gati 75 vjet. Por bota e sotme është po aq e rrezikshme sa në çdo kohë që nga Lufta e Dytë Botërore. "Vitet në vazhdim do të jenë sfidues dhe NATO duhet të vazhdojë të përballet me sfidën."

Teksa fliste për shpenzimet e mbrojtjes, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, tha se në raportin e tij të fundit të gjitha numrat dhe shifrat janë të përditësuar, si grafikisht dhe në tabela dhe tregojnë detajet për secilin aleat, ku shtatë aleatë shpenzojnë 2%. "Ne në fakt prisnim që kjo të ndodhte pak më herët, por për shkak se GDP është rritur më shumë se sa pritej për disa aleatë, dy aleatë që ne prisnim të ishin në 2%, tani janë pak më poshtë se 2%. Por të gjithë aleatët kanë rritje dhe më shumë aleatë tani shpenzojnë 2% të PBB-së për mbrojtjen, si dhe gjithnjë e më shumë aleatë po i afrohen 2%. Duke thënë këtë, nuk ka dyshim se duhet bërë më shumë dhe më shpejt. Ritmi që kemi kur bëhet fjalë për rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes nuk është mjaftueshëm i lartë. Kështu që mesazhi im për aleatët është se unë mirëpres atë që ata kanë bërë, por ata duhet të përshpejtojnë, ata duhet të japin më shumë në një botë më të rrezikshme, ne duhet të investojmë më shumë në mbrojtje". Ai shtoi se është e rëndësishme që aleatët të përbushin udhëzimin 2%, por nuk ka pa përmendur se edhe aleatët që kanë qenë afër 1% tani janë në 1.5, dhe po shkojnë drejt 2%". Kështu për shembull, Gjermania ka rritur ndjeshëm shpenzimet e mbrojtjes gjatë viteve të fundit. "Ajo nuk është ende në 2%, por rritja e shpenzimeve gjermane të mbrojtjes bën një ndryshim të madh për shkak të vëllimit të madh të ekonomisë gjermane dhe buxhetit gjerman të mbrojtjes dhe Gjermania është zotuar qartë që së shpejti të jetë në 2%".

Kujtojmë se Lufta e Rusisë në Ukrainë filloi në 2014 me aneksimin e paligjshëm të Krimesë, vazhdoi më tej me Donbasin lindor si dhe me pushtimin e plotë në shkurtin e kaluar. "Kjo gjë e ka bërë të rrezikshme situatën e sigurisë dhe ka shtuar sfidat dhe nëse në vitin 2014, ka pasur nevojë për të rritur shpenzimet e mbrojtjes kjo tani është domosdoshmëri". Ndërsa në vitin 2014, shumica e aleatëve të NATO-s reduktonin buxhetet e tyre të mbrojtjes me një tendencë rënëse, (vetëm tre aleatë shpenzonin 2%

në mbrojtje), që nga viti 2014 të gjithë aleatët kanë rritur shpenzimet e tyre të mbrojtjes si në Europë dhe në Kanada.

A ka një "plan kinez të paqes" në takimin e Presidentit Xi dhe Presidentit Putin?

Sekretari i Përgjithshëm, Stoltenberg, në konferencën për media, më 21 mars, kur publikoi raportin e tij vjetor 2022, i bëri thirrje Pekinit që të ketë parasysh kushtet e Ukrainës për paqe me Rusinë, ndërsa presidenti kinez, Xi Jinping ishte në Moskë e takohej me presidentin rus, Vladimir Putin. "Ukraina duhet të vendosë se cilat janë kushtet e pranueshme për çdo zgjidhje paqësore. Prandaj, Kina duhet të fillojë të kuptojë perspektivën e Ukrainës dhe të angazhohet drejtpërdrejt me Presidentin Zelensky nëse dëshiron të jetë serioze për paqen", - tha Stoltenberg. Ai kujtoi se Kina nuk ka qenë në gjendje të dënojë luftën e paligjshme të agresionit rus në Ukrainë. Por Stoltenberg tha se do të mirëpriste çdo iniciativë, çdo plan, që mund të çojë në një paqe të qëndrueshme. "Propozimi i paqes i Kinës përfshin disa aspekte dhe elemente pozitive të cilat unë i mbështes, për shembull rëndësinë e sigurisë bërthamore ose mbrojtjen e civilëve, dhe jo më pak duke nënvizuar rëndësinë e sovranitetit, integritetit territorial dhe pavarësisë. Çdo zgjidhje paqësore për Ukrainën, duhet të bazohet në këto parime, në respektimin e integritetit territorial dhe sovranitetit të Ukrainës. Ky është gjithashtu elementi kryesor i planit të paqes që Presidenti Zelensky paraqiti disa muaj më parë dhe sigurisht, çdo paqe e qëndrueshme duhet të respektojë Ukrainën si një komb sovran dhe i pavarur në Evropë në përputhje me Kartën e OKB-së. Një armëpushim ose ndonjë zgjidhje që nuk respekton sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës do të jetë vetëm një mënyrë për të ngrirë luftën dhe për të siguruar që Rusia të mund të rindërtohet, të rigrupohet dhe të risulmojë", - tha Stoltenberg. Kjo nuk do të jetë paqe e drejtë dhe e qëndrueshme, por ajo do ta ndihmojë Rusinë të mbajë territorin që ka pushtuar ilegalisht.

Lidhur me pyetjen nëse ka informacione se Kina po planifikon, apo po furnizon në të vërtetë Rusinë me armë për luftën në Ukrainë, Sekretari i Përgjithshëm tha se nuk kishte parë asnjë provë që Kina po i dërgon Rusisë armë vdekjeprurëse, por ai tha se kemi parë disa shenja. "Ka qenë një kërkesë nga Rusia dhe kjo është një çështje që konsiderohet në Pekin nga autoritetet kineze. Prandaj mesazhi ynë ka qenë që Kina nuk duhet të ofrojë ndihmë vdekjeprurëse për Rusinë. Kjo do të ishte për të mbështetur një luftë të paligjshme, dhe vetëm për të zgjatur luftën, dhe për të mbështetur pushtimin e paligjshëm të Ukrainës nga Rusia", - tha Stoltenberg. "Kjo është diçka që Kina nuk duhet ta bëjë". Ai tha se "takimi që zhvillohet në Moskë është pjesë e një modeli që kemi parë vitet e fundit, ku Kina dhe Rusia po afrohen gjithnjë e më shumë. Duhet të kujtojmë se vetëm disa javë, para pushtimit shkurtin e kaluar, Presidenti Xi dhe Presidenti Putin u takuan në Pekin, ku nënshkruan deklaratën e përbashkët, duke i premtuar njëri-tjetrit një partneritet pa asnjë kufi dhe ne shohim se si Kina dhe Rusia po afrohen gjithnjë e më shumë në fushën ushtarake, ato kanë stërvitje të përbashkëta, patrulla të përbashkëta, patrulla detare dhe ajrore, në fushën ekonomike, dhe gjithashtu në fushën politike dhe diplomatike. Pra, takimi në Moskë është pjesë e atij modeli ku Kina dhe Rusia po punojnë gjithnjë e më ngushtë dhe po ndërtojnë një partneritet gjithnjë e më të fortë".

2022, viti i tetë radhazi i rritjes së shpenzimeve të mbrojtjes

Viti 2022 ishte viti i tetë radhazi i rritjes së shpenzimeve të mbrojtjes në të gjithë Evropën dhe në Kanada. Vitin e kaluar, shpenzimet e mbrojtjes u rritën me 2.2% në terma realë. Që kur aleatët

78-VJETORI I THEMELIMIT TË SHKOLLËS USHTARAKE 'SKËNDERBEJ'

Historia e një shkolle legjendë

PANDELI BARDHI,
PUBLICIST

Historia e një shkolle legjendë, në kolanën me 5 volume "Skënderbegasit ndër vite", e autorëve Kujtim Boriçi dhe Maksim Fejzullai.

Më 28 mars 2023, mbushen plot 78 vjet kur çeli dyert në Tiranë shkolla e kadetëve, e cila më vonë mori emrin Shkolla e Mesme e Përgjithshme "Skënderbej", e vetmja shkollë e mesme me profil ushtarak në Shqipëri dhe shkolla e njohur elitare, me histori të madhe.

Në dekada, historia e kësaj shkolle është dëshmuar me dokumente dhe do të pasurohet ndër breza, por një meritë e veçantë, unikalë në vend, kjo histori është sjellë në kolanën "Skënderbegasit ndër vite", me pesë volume, të autorëve Kujtim Boriçi dhe Maksim Fejzullai.

Ndaj është domethënëse dhe përkujtimi i kësaj ngjarjeje të shënuar sot, nën okelion "Historia e një shkolle legjendë, nëpërmjet kolanës 5-volumëshe "Skënderbegasit ndër vite", i autorëve Kujtim Boriçi dhe Maksim Fejzullai.

Nuk marr përsipër të bëj analizë të hollësishme të kësaj pune voluminoze e profesionale të autorëve, sjellë me profesionalizëm, me dokumente, faksimile, foto e kujtime të protagonistëve, por po rendis pak gjëra nga ky historik...

...Sa herë kujtojmë Shkollën Ushtarake "Skënderbej", mendja na shkon në marsin e vitit 1945, kur në garnizonin e vjetër ushtarak të Laprakës, u mbledhën 200 partizanët e vegjël të moshës 14-15-vjeçare. Ishin këta kuadrot e parë që do të përgatiteshin për të drejtuar e komanduar njësitë, repartet dhe nënrepartet e ushtrisë sonë, në të gjitha nivelet.

Nuk kishin kaluar më shumë se tre muaj kur atdheu, më në fund, po merrte frymë i çliruar nga pushtuesit e tradhtarët, për të parën herë në historinë e tij. Nuk ishin shëruar akoma plagët në trupin e Atdheut, kur u betuan pionierët e parë, betim ky që do të vazhdonte derisa ajo mbylli dyert, duke e kryer me sukses misionin e saj pas më shumë se 47 vjetësh. Pas dy vitesh, kur u grumbulluan pionierët e parë, në shkurt të vitit 1947, me urdhër të Komandantit të Përgjithshëm të FA-së, shkolla mori emrin "Skënderbej", emër që kuadrot e të gjitha fushave dhe niveleve që drejtuan dhe komanduan me zotësi repartet dhe nënrepartet e ushtrisë dhe mbajtën lart emrin e Heroit tonë Kombëtar.

Por nuk është vetëm kjo periudhë lavdie e kësaj shkolle 47-vjeçare, lavdia e saj janë gjurmët që nuk do të fshihen kurrë, jo vetëm nga zemrat e atyre 45 mijë kuadrove që dolën nga bankat e saj, por as nga brezat e sotëm dhe të atyre që do të vijnë.

Ka një të veçantë kjo Shkollë Heroinë. Qysh nga pionierët e parë të saj të muajit mars 1945, e të gjithë atyre që do të vinin për afro një gjysmë shekulli, ishin të së njëjtës moshë, 14 dhe 15-vjeçarë. Ata ishin fëmijë të njerëzve të thjeshtë, puntorë e fshatarë, që vinin nga të gjitha krahinat e Shqipërisë, nga familje patriotike të lidhura ngushtë me Luftën Nacional Çlirimtare, familje dëshmorësh dhe ushtarakësh. Në zemrat e njoma të kësaj "letre të bardhë", kishin shkruar vetëm prindërit e tyre, vëllezërit dhe motrat që sakrifkuan shumë për lirinë e pavarësinë e Atdheut, me sakrificë të shumta, për të jetuar të lirë, të cilëve shteti u erdhi në ndihmë për kontributin e dhënë, nëpërmjet shkollimit të fëmijëve të tyre falas...

Në vazhdim, shkroi dora e Atdheut që ndjente akoma dhimbjet e plagëve të luftës, që rrënjosi thellë në mendjet dhe shpirtin e tyre, dashurinë për Shqipërinë, për familjen, shkroi dora e atyre komandantëve e komisarëve, mësuesëve dhe pedagogëve të mrekullueshëm që edukuan këta bij të denjë. Që në atë moshë u shkruan e u rrënjosi thellë edukata e shëndoshë, cilësitë e larta morale në vazhdim të idealeve partizane, që nuk kursyen as jetën për çlirimin e vendit, dashuria dhe respekti për të tjerët, për shokët dhe eprorët, korrektësia, mirësjellja, komunikimi i ngrohtë, përgjegjshmëria, gatishmëria dhe disiplina e lartë në kryerjen e ç'do detyre, cilësi këto, që jo vetëm u rrënjosi thellë, por edhe u trashëguan brez pas brezi.

Ushtarakët në përgjithsi, përfshi këtu edhe ata ish-skënderbegas, për vetë sakrificat që kanë bërë, e meritojnë ato ç'ka flitet edhe sot e do të flitet gjithmonë për oficerët, si pararojë e shoqërisë.

Këtë besnikëri dhe gatishmëri ndaj Atdheut, ushtarakët e kanë treguar edhe në kohën e ndërrimit të sistemit, kur ata i dolën për zot Atdheut, në mbrojtje të jetëve njerëzore e të pronës së përbashkët nga bandat e banditët. Këtë gatishmëri dhe besnikëri ndaj Atdheut, ushtarakët e treguan edhe më vonë, në ngjarjet



e dhimbshme të vitit 1997, ku megjithëse kishin dalë në lirim, përsëri iu përgjigjën thirrjes së Atdheut për t'i dalë zot në kohë të vështira, pavarësisht që këto vështirësi, vinin nga të vetët dhe jo nga pushtuesit e huaj. Asnjëherë ushtria dhe ushtarakët nuk kanë qenë në shërbim të njërit apo të tjetrit krah të politikës dhe as në mbështetje të politikaneve, që kanë pasur synim marrjen e pushtetit, por gjithmonë në shërbim e të gatshëm për të mbrojtur interesat e Atdheut.

Çdokush sot, që kujton skënderbegasit ish-komandantë, komisarë, gjeneralë e ushtarakë madhorë, komandantë, specialistë, pilotë e detarë të shquar, ministra, profesorë e shkencëtarë, deputetë e artistë të mëdhenj, sportistë e mjeshtra sporti, ambasadorë, poetë e shkrimtarë, gazetarë, biznesmenë, politikanë etj., (pasqyruar denjësisht e hollësisht në kolanën e Boriçit dhe Fejzullait), ndjen një krenari të ligjshme për kontributin e tyre, përpjekjet dhe djersën e derdhur që krahas të tjerave, kanë edhe merita të padiskutueshme që e kanë bërë aq të njohur Shqipërinë edhe në arenën ndërkombëtare.

Nuk mund të gjesh një shkollë tjetër si kjo 'Fidanishte' e Ushtrisë, që e kreu në mënyrë kaq shembullore misionin e saj.

Duke filluar nga viti 1960, rreth 60% e nevojave të ushtrisë për oficerë merreshin nga Shkolla "Skënderbej". Në këtë rrugë të gjatë historike, që nga brezi i parë me pionierët e luftës, deri në vitin 1992, kur shkolla u mbyll, shumë skënderbegas kanë dhënë jetën në krye të detyrës dhe janë shpallur dëshmorë të atdheut si në aviacion, këmbësori, xhenio, artileri etj. Me mijëra kanë dalë në pension dhe të tjerë vazhdojnë të shërbejnë në radhët e Forcave të Armatosura si drejtues e komandantë të të gjitha niveleve, deri në Shtabin e Përgjithshëm.

Historia e shkollës së mesme ushtarake "Skënderbej" është një fill i pashkëputur mësimi, edukimi e formimi atdhetar, kulturor dhe ushtarak. Aty u përvijuan më së miri prirjet, pasionet dhe talentet, morën rrugë profesionet e ardhshme, u krijuan lidhje shoqërore e miqësore të singqerta e të pandërprera ndër vite. Edhe sot e kësaj dite ne na lidh ajo vatër e ngrohtë dhe na mban të fortë e të rinj, si pjesëtarë të një familjeje të madhe e të pashoqe, çka e bën historinë e saj, një libër me të vërtetë mjaft të bukur e domethënëse.

Krahas gjurmëve që kanë lënë komandantët e Komisarët ndër vite, specialistët e llojeve të armëve e shërbimeve, janë edhe krijuesit, shkrimtarët e poetët, gazetarët e artistët, kritikët e analistët, të cilët me punën e tyre kanë bërë dhe bëjnë atë që dashuria për këtë shkollë të mos humbasë kurrë shkëlqimin e saj.

Ajo ç'ka vlen për të theksuar, është merita e padiskutueshme e personelit mësimdhënës, mësuesë dhe pedagogë nga më të zgjedhurit, të aftë dhe me integritet të lartë. Skënderbegasit nuk mund të harrojnë mësuesit Stavri Angjeli, Adriatik Kallulli, Perikli Jorgoni, Kozma Vasili, Flutura Xoxe, Agime Çela, Marije Nano, Viron Cinxo, Viron Tane, Vedat Cami, Ali Neviri, Gjylizar Çiço, Sami Bogdani, Dhurata Ylli, Petrit Caslli, Bejkush Birçe, Besnik Korshuni e dhjetëra e dhjetëra të tjerë, që janë e do të mbeten modeli i mësimdhënësve...

Autorëve Kujtim Boriçi dhe Maksi Fejzullai, u është dashur

një punë e madhe voluminoze dhe sakrificë të shumta për të na sjellë të pesë librat e kolanës "Skënderbegasit ndër vite", të cilët me një përkushtim për t'u admiruar, na kanë bashkuar të gjithëve ne, jo vetëm skënderbegasit por edhe eprorët tanë, komandantë e komisarë, mësues e pedagogë ndër vite, shkrimtarë, poetë e gazetarë, piktorë e dramaturgë, regjisorë dhe aktorë të fushave të ndryshme, në një trup të vetëm e në shërbim të një qëllimi të vetëm...

Janë këta qindra e mijëra kuadro bashkë të të gjitha specialitetëve dhe profesioneve ata që bëjnë të mundur që sa më shumë vitet të kalojnë aq më shumë kjo shkollë e dashur vjen pranë, me të gjithë madhësinë e saj ashtu si e kanë "qëndisur" krijuesit e shumë që kanë dalë nga bangat e saj, që "brumin" dhe frymëzimin e kanë marrë nga bankat e kësaj shkolle.

Populli, e në mënyrë të veçantë strukturat ushtarake, krenohen edhe sot mbas kaq viteve e do të krenohen edhe në të ardhmen me dramaturgë, publicistë, shkrimtarë, gazetarë, piktorë, studiues e kritikë të tillë si Bashkim Kozeli, Arben Duka, Kujtim Boriçi, Shpendi Topallaj, Halil Qëndro, Filip Rrumbullaku, Sazan Gjomema, Spiro Xhavera, Demir Rusi, Fluturak Gërmenji, Zenun Ferro, Halil Laze, Petraq Kote, Arben Bllaci, Fuat Çeliku, Demokrat Anastasi, Mina Qirici, Shefqet Vangjeli, Apostol Duka, Thanas Tane, Pandeli Ristani, Bibë Kaza, Agron Goga, Roland Qafoku, Apostol Duka, Fejzo Lala, Bashkim Alushi etj...

Një tjetër fushë (pasqyruar gjerësisht në kolanën e autorëve) është ajo e sportit, me të gjitha llojet e sporteve, me sportistë nga më të shkëlqyerit, të njohur jo vetëm brenda vendit, por edhe në arenën ndërkombëtare, që e kanë bërë të njohur Shqipërinë. Kujtojmë këtu sukseset e Ansambllit të Ushtrisë në ç'do vend të Europës dhe jo vetëm në atë Lindore, apo skuadrën e futbollit "Partizani", për vendin e nderit në disa kampionate midis ish-vendeve socialiste e deri në Azi, spartakiadat sportive në përvjetorë të ndryshëm të Atdheut dhe ushtrisë. Nuk kanë mbetur prapa skënderbegasit edhe në sporte të ndryshme si not, atletikë, basketboll, volejball, boks, mundje, ngritje peshash etj., sidomos nga strukturat e ushtrisë me bazë Shkollën Ushtarake "Skënderbej".

Krijuesit e shumë skënderbegas, me krijimet e tyre e kanë ngritur lart lavdinë e kësaj shkolle e njëherësh, kanë ngritur lart moralin e ushtrisë sepse në veprat e tyre kemi ndier frymëmarrjen e Atdheut, punën vetëmohuese në të katër anët e tij, ngritjen e veprave madhështore, kemi shijuar bukurinë e tij, kemi dëgjuar zhurmën e fabrikave dhe uzinave, shkolla ku kemi marrë dijet, këngët e aksioneve të shumta në vepra të ndryshme, ku pjesëmarrës kanë qenë edhe skënderbegasit.

...Kemi të drejtë, të nderuar pjesëmarrës, që edhe në këtë përvjetor e në përvjetorë të tjerë, ne dhe pasardhësit tanë të krenohen me këtë shkollë legjendë, me këtë model të një shkolle të vërtetë ushtarake, që edhe brezat që do të vijnë kanë shumë për të mësuar...

Urime autorëve Boriçi & Fejzulla në këtë ndërmarrje të madhe.

Bukuritë shqiptare, 'bekim zotash'

Turizmi malor

Territori i Shqipërisë është i pasur me male dhe kodra, të cilat zënë 2/3 e sipërfaqes së vendit, të përhapura gjerësisht nga veriu deri në jug. Pikat më të rëndësishme malore janë Dajti, Llogoraja, Dardha, Brozdoveci, Voskopoja, Valbona e Thethi. Këto pika ofrojnë mundësi të shumta natyrore për të praktikuar aktivitete të shumta si: alpinizëm, trekking, ecjet, skitë, eksplorimin e shpellave (speleologjinë), biçikletat malore etj.

Për sa i përket alpinizmit, Shqipëria ka tashmë një traditë të admirueshme. Federata Shqiptare e Alpinizmit, e cila është themeluar në vitin 1958, ka organizuar dhe organizon veprimtari alpinistike në rajonet më spektakolare të Shqipërisë. Zonat më të rëndësishme për sportin e alpinizmit, janë Jezerca, mali i Hekurave, Razma e shumë të tjera në Alpe, Munella në Pukë, Korabi, Radomira dhe Lura në rrethin e Dibrës, Gjallica në rrethin e Kukësit, Biza në rrethin e Tiranës, mali i Cikës në rrethin e Vlorës, mali i Tomorit në Berat, Gjinari në Elbasan, mali i Rrunggajës në Vithkuq, në parkun e Qafë Shtamës në rrethin e Krujës etj. Përveç sportit të alpinizmit, majat e maleve dhe territoret malore janë tërheqëse për ndërtimin e kampingjeve dhe akomodimin me çadra. Sigurisht, kjo gjatë stinës së ngrohtë, pasi dimri në lartësi të mëdha është i ashpër dhe e bën të pamundur, jo vetëm ngjitjen, por edhe ndërtimin e një kampingu.

Territori i Shqipërisë ofron mundësi të mëdha për të ushtruar edhe veprimtari të trekkingut dhe ngjitjeve malore. Zonat ku mund të zhvillohen këto veprimtari janë të shtrira nga veriu në jug. Tërheqës është programi i trekking-ut i quajtur "trekkingu i Çikës", i cili zhvillohet në zonën jugperëndimore të vendit, duke përfshirë luginën e përroit të Dukatit, vargun e Çikës, zonën e Kurveleshit dhe përfundon në bregdetin Jonian. Ky trekking zhvillohet përgjatë itinerarit Dukat-Tërbaç-Vranisht-Kuç-Kudhës-Qeparo. Zona të tjera të përshtatshme për trekking dhe ngjitje alpinistike janë Alpet e Shqipërisë në pika të tilla si: Vermosh, Theth, Razëm, Bogë, Valbonë, etj. Mali Tomorit i shtrirë në rrethet e Beratit dhe Skraparit. Vithkuqi, Voskopoja, Drenova në rrethin e Korçës, Guri Kamjes në rrethin e Pogradecit, lugina e Drinos në zonën e Dropullit në rrethin e Gjirokastrës si dhe itinerari Borsh-Zhulata që përshkon Kurveleshin etj.

Shëtitjet me këmbë janë një mënyrë tjetër për të shijuar natyrën, duke bërë njëkohësisht edhe aktivitet fizik. Në të gjitha vendet malore evropiane, shëtitjet apo ecjet e gjata në këmbë janë baza e turizmit aktiv, pasi ky aktivitet shtrihet në të gjitha moshat. Në Shqipëri ecja në këmbë është gjithashtu një sport tepër i aplikuar, pasi natyra dhe territoret me shtigje të ngushta dhe monopate, ofrojnë një kënaqësi të veçantë. Zakonisht për grupe të ndryshme janë udhërrëfyes banorët e fshatrave pranë, të cilët e njohin mirë zonën. Shëtitjet me këmbë janë të prekshme nga të gjithë, mjafton dëshira për të kaluar një pjesë të kohës së lirë në natyrë, jashtë jetës frenetike të qytetit.

Sporti i skive është veçanërisht i zhvilluar në zonën e Korçës, e cila njihet për resortet e saj të skive. Zona kryesore për



zhvillimin e sporteve dimërore është pika malore e Voskopojes si dhe pista e Bigëllit në Boboshticë, ku zhvilloheshin edhe garat e Kampionatit Kombëtar të Skive, përmendim këtu edhe Shishtavecin në zonën e Kukësit, Dardha në rrethin e Korçës, alpet Shqiptare me Razmën, Bogën, Thethin dhe Grabovën në rrethin e Gramshit.

Voskopoja: Voskopoja ndodhet rreth 21 km nga Korça, mbi një pllajë 1160 m mbi nivelin e detit. Karakteristikë e vendit është ajri i pastër dhe uji i freskët dhe kurativ. Gjatë dimrit praktikohet sporti i skive.

Razma: Fshati i Razmës ndodhet rreth 41 km në veri të Shkodrës. Ai është vendi ideal për të praktikuar alpinizmin malor dhe skitë. Fshatrat e tjerë rreth tij: Vermoshi, Boga dhe Vukli janë unik për bukurinë e tyre natyrore. Kjo zonë shquhet



të ktheheni prapë (syri i kaltër, dhe vaskat e Gurit në Ndërlyse do të jenë tunduese nëse nuk jeni të vendosur për sa kohë do të qëndroni atje).

Parku i Llogorasë gjendet rreth 40 km në juglindje të qytetit të Vlorës, në kufirin mes detit Adriatik dhe detit Jon. Afër Qafës së Llogorasë takohen drurë me forma kurorash mjaft interesante në të cilat ndihet ndikimi i rrymave të erës. Jo në shumë vende mund t'i gjeni bjeshkën dhe plazhet në një vend, me vetëm disa minuta ecje mund të lëshoheni nga ambienti malor në atë bregdetar dhe të shijoni verën me dy opsione pushimi.

Parku Kombëtar i Valbonës ka një sipërfaqe prej 8000 ha dhe konsiderohet si mrekullia e Alpeve Shqiptare. Ndodhet 25-30 km në veri-perëndim të qytetit të Bajram Currit. Shtrihet midis majave të larta e të thepisura të mbuluara me një kolorit fantastik ngjyrash në çdo stinë, duke i dhënë kështu imazhin e një lugine plot labirinte dhe të papritura. Mundësi të mrekullueshme akomodimi dhe pushimi, si dhe për ata që i adhurojnë aktivitetet sportive në natyrë, mundësitë që ofron Valbona janë të shumta, duke filluar nga shtigjet për ecje, terrene për të bërë kamp etj.

Ka kohë që Mali i Dajtit është një prej lokacioneve më të pëlqyera dhe më të vizituara, jo vetëm nga vendasit por edhe nga turistët e huaj që vizitojnë Shqipërinë. Ajri i pastër, freskia dhe qetësia e bëjnë këtë vend shumë të përshtatshëm për pushime, larg stresit dhe zhurmës së jetës në qytet. Mali i Dajtit ndodhet 26 km larg Tiranës dhe 50 km larg Aeroportit "Nënë Tereza".

Dhe për të pasur një eksperiencë më të mrekullueshme ju mund të shfrytëzoni teleferikun për t'u ngjitur në majë, për vetëm 15 minuta ju mund të përjetoni fluturimin në një lartësi prej 300 metrash deri në 1100 metra lartësi mbi det.



për traditën në bujari dhe mikpritje.

Të apasionuarit pas natyrës dhe ata që e pëlqejnë turizmin malor, vetëm 70 kilometra larg qytetit të Shkodrës gjendet 'parajsa në tokë' që e ka emrin Theth, me ujëvarat që të lënë pa frymë, bimë dhe drurë të llojlojshëm, akomodim dhe ushqim në shtëpitë tradicionale malësore, dhe me atraksione që do t'ju bindin



A po rrotullohet Toka më shpejt?

Po, Toka papritmas po rrotullohet më shpejt.

Planeti ynë, Toka, po nxiton. Më 29 qershor 2022, Toka përfundoi ditën më të shkurtër që kur shkencëtarët filluan të mbanin shënime në vitet 1960, duke bërë një rrotullim të plotë 1,59 milisekonda më shpejt se zakonisht.

Nxitimi tokësor është një trend. Në vitin 2020, planeti regjistroi 28 ditët më të shkurtra të regjistruara ndonjëherë dhe vazhdoi të rrotullohej me shpejtësi deri në vitin 2021 dhe 2022. Përpara se shkencëtarët të mund ta verifikonin atë ditë rekord të 29 qershorit, bota jonë pothuajse e tejkaloi veten: Ajo u nis deri më 26 korrik 2022, 1.50 milisekonda përpara afatit.

Ne, ka të ngjarë të shohim më shumë ditë të shkurtra që regjistrohen ndërsa Toka vazhdon të përshpejtohet, thotë Judah Levine, një profesor në Universitetin e Kolorado-Boulder dhe ekspert për një kohë të gjatë në Institutin Kombëtar të Standardeve dhe Teknologjisë (NIST). Fakti që ditët e Tokës po shkurtohen nuk është shkak për alarm, thotë ai, sepse diferenca aktuale kohore arrin në fraksione të sekondës gjatë një viti. Por ajo që është e çuditshme është se, ndërsa shkencëtarët e dinë se ndryshimet në shtresat e brendshme dhe të jashtme të Tokës, oqeanet, baticat dhe klimën mund të ndikojnë në shpejtësinë e rrotullimit, ata nuk e dinë se çfarë e nxit nxitimin aktual.

Askush nuk është i përsosur, madje as planeti ynë

Mesatarisht, Toka rrotullohet rreth boshtit të saj çdo 24 orë, ose çdo 86,400 sekonda. Por për arsye të ndryshme, nga forma e papërsosur e planetit deri te brendësia e tij e ndërlikuar, çdo ditë nuk ka saktësisht të njëjtën gjatësi si një ditë më parë.

Për më tepër, një ditë që zgjat saktësisht 24 orë është thjesht një standard që ne kemi pritur që tani. Rrotullimi i Tokës po ngadalësohet në terma afatgjatë falë tërheqjes së Hënës në botën tonë. Vetëm disa qindra milionë vjet më parë, për shembull, një ditë e Tokës ishte vetëm 22 orë e gjatë. Në mijëvjeçarët që do të vijin, një ditë e Tokës do të zgjasë shumë më gjatë.

Pra, çfarë vjen me ditët më të shkurtra të kohëve të fundit, të cilat e zvogëlojnë trendin afatgjatë? Një hipotezë që është hedhur deri më tani ka të bëjë me "luhatjen e Chandler". I zbuluar në vitet 1800, fenomeni shpjegon se si Toka, me formë jo plotësisht të rumbullakët, lëkundet kaq pak, si një majë rrotulluese ndërsa ngadalësohet. Leonid Zotov tha për timeanddate.com se lëkundjet ishin zhdukur në mënyrë misterioze midis 2017 dhe 2020, gjë që mund ta kishte ndihmuar Tokën ta përfundonte ditën pak më shpejt.

